



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQËNIES SOCIALE  
SPITALI RAJONAL “MEMORIAL” FIER

Nr. \_\_\_ Prot

Fier më \_\_\_ / \_\_\_ / 2026

**Lënda : Njoftim Punësimi**

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK**

**TIRANË**

Drejtoria e Spitalit Rajonal “Memorial” në Fier, shpall njoftimin për konkurim të hapur, për pozicionet si vijon :

- Përkthyes, në Sektorin e Koordinimit me Pacientin (dy vende pune)

**1. Përkthyes**, në Sektorin e Koordinimit me Pacientin pranë Spitalit Rajonal “Memorial” Fier (dy vende pune)

Kandidatët që konkurojnë për vendin e punës “Përkthyes” në Sektorin e Auditit, duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të jenë shtetas shqiptarë me zotësi të plotë për të vepruar;
2. Të kenë eksperiencë pune prej jo më pak se dy vjet në përkthim ;
3. Të njohin mirë gjuhën turke (në të folur dhe shkruar) ;
4. Të jenë në gjendje të përkthejnë simulant nga gjuha shqipe-turke dhe anasjelltas ,
5. Të mos jenë marrë ndaj tyre masa disiplinore të largimit nga puna.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së Drejtorisë në Spitalin Rajonal ‘Memorial’ në Fier këto dokumenta :

1. Letër motivimi
2. Jetëshkrimi ( CV)
3. Fotokopje të noterizuar e diplomës të shkollës së lartë.(Për kandidatët që kanë studiuar jashtë vendit diploma e tyre duhet të jetë e njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit);
4. Fotokopje e noterizuar e librezës së punës;
5. Dëshmi të aftësisë shëndetësore për punë e 3 (tre) muajve të fundit;
6. Fotokopje e letërnjoftimit (ID);
7. Referencë pune ( n.q.s ka qënë i/e punësuar), për të vërtetuar përvojën e auditimit e brendshëm;
8. Vërtetim banimi;
9. Vërtetim nga gjykata,dhe prokuroria që nuk është në ndjekje penale dhe gjykimi;

10. Vërtetimi i gjendjes gjyqësore lëshuar nga Ministria e Drejtësisë (Dëshmi penalteti e tre muajve të fundit);
11. Çertifikatë familjare/personale
12. Çertifikata ose rekomandime që vërtetojnë eksperiencën profesionale si dhe integritet moral dhe reputacion të mirë;

Mosparaqitja e dokumentave ose mosparaqitja e plotë e tyre, sjell s'kualifikim të kandidatit;

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin dokumentat brenda 7 (shtatë) ditëve nga shpallja në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) , në faqen zyrtare të Spitali Rajonal “Memorial”Fier, “Vende të lira pune”, si dhe e publikuar në platformën “puna.gov.al”.

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet vlerësimit të dosjes dhe vlerësimit të intervistës, sipas kriterit të meritës dhe transparencës

Kandidatët konkuroes do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen / njoftimi i fituesit